



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Java VI

Cfarë është Projekti

Një set unik i aktiviteteve të koordinuara, me afat të definuar të fillimit dhe mbarimit, të ndërmarra nga një individ ose organizatë për të përmbushur objektivat specifike brenda orarit të përcaktuar, koston dhe parametrave të performancës.



Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

|

Përkufizimi i projektit

- ▶ Zhvillimi i konceptit; Përcaktimi i Fushëveprimit të Projektit;
- ▶ Qëllimi dhe objektivat e projektit;
- ▶ Struktura e Zberthimit të Punës;
- ▶ Elementet kryesore të një projekt propozimi, Rezultatet e pritura, Monitorimi dhe vlerësimi i projektit.



Menaxhimi i Projekteve;

Përkufizimi i projektit

Zhvilimi i konceptit; Përcaktimi i Fushëveprimit të Projektit;

Qëllimi dhe objektivat e projektit;

Hartimi i projekt propozimit;

Elementet kryesore të një projekt propozimi, Rezultatet e pritura, Monitorimi dhe vlerësimi i projektit.

Suksesi i Projektit

Select a dream

Use your dream to set a goal

Create a plan

Consider resources

Enhance skills and abilities

Spend time wisely

Start! Get organized and go

. . . it is one of those acro-
whatever's,
said Pooh.*

S-Zgjidh një ëndërr

U-Përdor ëndrrën tuaj për të
vendosur një objektiv

K-Krijoh një plan

Konsideroni burimet

S-Përmirëso aftësitë dhe
mundësitë

E-Shpenzoni kohën me mençuri

S-Filloni! Organizohuni dhe
vazhdoni

* Roger E. Allen and Stephen D. Allen, Winnie-the-
Pooh on Success (New York: Penguin, 1997), p. 10.




Fushëveprimtaria e Projektit

- ▶ Përkufizimi i fushëveprimtarisë së projektit përcakton bazat për zhvillimin e një plani të projektit. Fushëveprimtaria e projektit është një përkufizim i rezultatit përfundimtar apo misionit të projektit tuaj - një produkti apo shërbimi për klientin tuaj.
- ▶ Qëllimi kryesor është që të përcaktojë qartazi rezultatet për përdoruesit e fundit dhe të përqendrohet në planet e projektit. Sic paraqitet thelbësore përkufizimi i fushëveprimtarisë, ajo është anashkaluar shpesh nga drejtuesit e projekteve të menaxhuar tek korporatat e mëdha.

Qëllimi I Projektit

- ▶ Projektet fillojnë që të zhvillohen, vetëm mbasi janë bërë planifikimi sistematik - menaxhimi i qëllimit.
- ▶ Gjashtë aktivitetet kryesore janë:
 - 1)zhvillimi i konceptit,
 - 2)bërja e qartë e qëllimit apo shpallja e tij,
 - 3)autorizimi për punën,
 - 4)raportimi për qëllimin,
 - 5)sistemet e kontrollit dhe
 - 6)mbyllja e projektit.



Qëllimi I Projektit

- ▶ Objektivi i menaxhimit të qëllimit është **të maksimizohet eficienca nëpërmjet hartimit dhe ekzekutimit të planeve** në mënyrë që rastësisë ti lihet sa më pak të jetë e mundur.
- ▶ Thënia e hershme që “Mund të kontrollohet çfarë është planifikuar” është e vërtetë: pra përcaktimi i qartë i projektit përbën hapin e parë.



ZHVILLIMI I KONCEPTIT

Për të qenë efektiv, përcaktimi i problemit duhet të bëhet sa më thjesht e të bazohet në njohjen e qartë të nevojave për të cilat kërkohen zgjidhje. Për shembull, përcaktimi i qartë i qëllimit të projektit si “ përmirësimi i procesit të prodhimit për të ulur koston me 20 %” është shumë më mirë se sa përcaktimi i një qëllimi që e ngarkon grupin e projektit me “reduktim të konsiderueshëm të koston së prodhimit”.

Zhvillimi i konceptit përfshinë:

- ▶ Deklarimin e problemit apo nevojës
- ▶ Grumbullimin e informacionit
- ▶ Kushtëzimet
- ▶ Analizën e alternativave
- ▶ Objektivat e projektit



PËRCAKTIMI I PUNËS

Përcaktimi i punës (PIP) është **një përshkrim i detajuar i punës** që kërkohet për projektin. Ky përcaktim përmban informacion për objektivat kryesore të projektit, një përmbledhje të përshkrimit të përgjithshëm të punës që do të kryhet, të rezultateve që priten të projektit dhe çdo kushtëzim për financimin dhe afatin kohor të projektit.



PËRCAKTIMI I QËLLIMIT TË PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është një koncept që lidhet me përcaktimin e rezultatit përfundimtar apo të misionit të projektit- produktit apo shërbimit për klientin tuaj.

Qëllimi kryesor është që të përcaktohen sa më qartë që të jetë e mundëshme rezultati (apo rezultatet) për përdoruesin final dhe fokusin e planit të projektit.



PËRCAKTIMI I QËLLIMIT TË PROJEKTIT

- ▶ Përcaktimi i qëllimit të projektit është një dokument që bëhet i ditur dhe përdoret nga pronari i projektit dhe pjesëmarrësit në projekt, për të planifikuar dhe për të matur suksesin e projektit.
- ▶ Qëllimi përshkruan se çfarë pritet për t'i dhënë klientit kur projekti të përfundojë. Qëllimi i projektit duhet të përcaktojë rezultatet që do të arrihen në terma specifik, të prekshëm dhe të matshëm.



Elementët e përcaktimit të punës

Data e paraqitjes

Numri i rishikimit

Emri i projektit

Numri i Identifikimit të Projektit

PIP i përgatitur nga

1. Përshkrimi dhe Qëllimi

- Përmbledhja e punës që kërkohet
- Backgraurdi
- Përshkrimi i elementëve kryesorë (rezultateve) të projektit të përfunduar.
- Përfitimet që priten
- Elementët që nuk përfshihen në qëllim
- Prioritetet që i jepen çdo elementi në projekt.

2. Metoda

- Momente kryesore kritike/ngjarjet kryesore të parashikuara

Data	Momenti kritik/ngjarja

- Standartet ose metodologjitë speciale që duhen observuar
- Ndikimi në sistemet apo projektet ekzistuese
- Supozimet kritike për projektin
- Planet për azhornimin e raportit të statusit
- Procedurat për ndryshimin e qëllimit apo të punës.

3. Kërkesat për burime

- a) Plan i detajuar për nevojat për burime
- b) Nevojat për burime të tjera materiale (hardware, software, materiale, etj.)
- c) Angazhimet që piten të departamenteve të tjera për mbështetje.
- d) Shqetësimet apo alternativat që lidhen me planin e pajisjes me staf.

Personi	Roli

4. Risqet dhe shqetësimet

- a) Risqet e mjedisit.
- b) Risqet e parashikuara nga klientët
- c) Risqet konkurruese
- d) Risqet teknike në zhvillimin e projektit
- e) Kushtëzimet e projektit
- f) Vlerësimi i përgjithshëm i riskut
- g) Strategjitë e reduktimit të riskut

5. Kriteret e pranuar

- a) Procesi dhe kriteret e detajuara të pranimi
- b) Metoda e testimit/kualifikimit
- c) Përfundimi i projektit


6. Vlerësimi i kohës dhe i kostos

- a) Koha dhe kosto e vlerësuar për përfundimin e projektit
- b) Kosto e parashikuar për vazhdimin.

PËRDORIMI I CHECKLIST PËR QËLLIMIN E PROJEKTIT

Duhet të jetë e qartë se qëllimi i projektit përbën elementin kyç dhe më kryesor të gjithë elementëve të planit të projektit. Për të siguruar në lidhje me përcaktimin e qëllimit të projektit, mund të përdoret checklist e mëposhtëm:

- ▶ Objektivi i projektit
- ▶ Rezultatet
- ▶ Momentet kritike
- ▶ Kërkesat teknike
- ▶ Kufizimet dhe përjashtimet
- ▶ Shqyrtimet me klientët



PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE TË PROJEKTIT

Cilësia dhe sukcesi përfundimtar i projektit tradicionalisht përcaktohen si përmbushja dhe/ose tejkalimi i pritjeve të klientit dhe/ose nivelit të ulët të menaxhimit në lidhje me koston (buxhetin), kohën, dhe performancën (qëllimin) e projektit. Ndërlidhja ndërmjet këtyre kriterëve varion. P.sh. shpesh është e nevojshme që të bëhet kompromis ndërmjet performancës dhe qëllimit të projektit për të mundësuar bërjen më shpejt të projektit apo me koston më të ulët të tij.

Një ndër detyrat kryesore të menaxhimit të projektit është që të menaxhojë kompromiset ndërmjet kohës, koston dhe performancës. Për ta bërë këtë menaxherët e projektit duhet të përcaktojnë dhe të njohin natyrën e prioriteteve të projektit.



PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE TË PROJEKTIT

vazhdim

Një teknikë që zbatohet në praktikë dhe është e vlefshme për këtë qëllim është ndërtimi i **matricës së prioritetit** për projektin për të identifikuar se për cilin kriter kemi kushtëzim, cili duhet të vlerësohet apo përforcohet më shumë dhe cili mund të pranohet.

Kushtëzim – kemi kur parametri origjinal është i fiksuar apo përcaktuar. Projekti duhet të përmbushë afatin e përfundimit, specifikimet dhe qëllimet projektit, ose buxhetin.

Vlerësim apo forcim – nënkupton që për një qëllim të dhënë të projektit, cili kriter duhet optimizuar? Në rastin e kohës dhe kostos, kjo zakonisht nënkupton se prej cilës përfitohet më shumë, duke reduktuar koston apo duke shkurtuar kohën.

Pranim – për cilin kriter është e mundëshme tolerancë nga mos përmbushja e parametrave origjinal? Kur kompromisi duhet të bëhet është e lejueshme që skeduli të devijojë, që të reduktohet qëllimi dhe performanca e projektit apo që të kapërcehet buxheti?



PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE TË PROJEKTIT

vazhdim

	Koha	Performanca	Kosto
Kushtezim		ð	
Perforcim	ð		
Pranim			ð

Matrica E prioriteteve te projektit




STRUKTURA E ZBËRTHIMIT TË PUNËS (SZP)

- ▶ Struktura e Zbërthimit të Punës është “një grupim i elementëve të projektit të orientuar drejt rezultateve që kërkohen të arrihen e cila organizon dhe paraqet sipas niveleve çdo komponent të projektit”.
- ▶ SZP është një hartë e projektit. Përdorimi i saj ndihmon për të siguruar menaxherët e projektit që të gjithë produktet dhe elementët e punës janë identifikuar, për të integruar projektin me organizatën aktuale dhe për të përcaktuar bazën e kontrollit.

STRUKTURA E ZBËRTHIMIT TË PUNËS (SZP)

vazhdim



SI E NDIHMON SZP MENAXHERIN E PROJEKTIT

SZP përcakton të gjithë elementët e projektit në një strukturë hirarkike dhe përcakton lidhjet e tyre me elementët finalë të projektit.

Secili prej elementëve në SZP i nevojitet vlerësimi i kohës dhe i kostos.

SZP shërben gjithashtu edhe si strukturë mbështetëse për të ndjekur performancën e punës dhe të kostos.

SZP mund të përdoret gjithashtu edhe për të përcaktuar kanalet e komunikimit dhe për të ndihmuar në njohjen dhe koordinimin e shumë pjesëve të projektit.



QËLLIMET E STRUKTURËS SË ZBËRTHIMIT TË PUNËS

SZP i shërben gjashtë qëllimeve kryesore:


1. Sinjalizon për objektivat e projektit.
2. Është një skemë organizimi e projektit.
3. Krijon logjiken për ndjekjen e kostos, të kohës dhe specifikimeve të performancës për çdo element të projektit.
4. Mund të përdoret për të komunikuar statusin e projektit.
5. Mund të përdoret për të përmirësuar komunikimin e projektit.
6. Demonstron se si do të kontrollohet projekti.



STRUKTURA E ZBËRTHIMIT TË PUNËS (SZP)

Të konsiderojmë rastin e një spitali të madhe në një zonë urbane që ka marrë vendimin për futjen e një sistemi teknologjie informacioni (IT) për faturimin, marrjen e pagesave, mbajtjen e rekordeve për pacientët.

Metoda bazë për identifikimin e hapave për projektin e instalimit të këtij sistemi të ri informacioni janë:




STRUKTURA E ZBËRTHIMIT TË PUNËS (SZP)

Metoda bazë për identifikimin e hapave për projektin e instalimit të këtij sistemi të ri informacioni janë:

1. IT e përshtatshme për detyrat dhe problemet e organizatës.
2. Identifikimi i nevojave të përdoruesit të IT.
3. Përgatitja e propozimit informal për menaxhimin e lartë (apo marrësit e tjerë të vendimeve) për marrjen e IT.
4. Kërkimi dhe marrja e një konsulenti IT.
5. Kërkimi i stafit dhe mbështetja e departamentit për IT.
6. Identifikimi i vendndodhjes më të përshtatshme brenda org. për vendosjen e hardware.
7. Përgatitja e propozimit formal për prezantimin dhe futjen IT.
8. Përgatitja e kërkesës për propozim (RPF) për ofruesit e IT.
9. Drejtimi i projektit pilot (ose disa projekteve pilot që përdorin variante të ndryshme të IT).
10. Bërja e kontratës së blerjes.
11. Adaptimi dhe përdorimi i teknologjisë IT.

Zbërthimi	SZP	Kodi	Përshkrimi
		1.0	Projekti i Instalimit të IT
Rezultati 1		1.1	IT e përshtatshme për detyrat dhe problemet e organizatës.
PP1	1.1.1		Drejtimi i analizës së problemit
PP2	1.1.2		Hedhja e informacionit të teknologjisë IS
Rezultati 2		1.2	Identifikimi i nevojave të përdoruesit të IT.
PP1	1.2.1		Investimi i përdoruesve të mundshëm
PP2	1.2.2		Bërja e prezantimit për përfitimet
PP3	1.2.3		Sigurimi i blerësit të sistemit
Rezultati 3		1.3	Përgatitja e propozimit informal për menaxhimin e lartë (apo marrësit e tjerë të vendimeve) për marrjen e IT.
PP1	1.3.1		Përpunimi i informacionit kosto/përfitim
PP2	1.3.2		Sigurimi i mbështetjes së menaxhimit të lartë
Rezultati 4		1.4	Kërkimi dhe marrja e një konsulenti IT.
PP1	1.4.1		Delegimi i anëtarëve në grupin e kërkimit
PP2	1.4.2		Zhvillimi i kriterëve të zgjedhjes
PP3	1.4.3		Intervistimi dhe zgjedhja e konsulentit
Rezultati 5		1.5	Kërkimi i stafit dhe mbështetja e departamentit për IT.

Rezultati 6		1.6	Identifikimi i vendndodhjes më të përshtatshme brenda organizatës për vendosjen e hardware të IT.
PP1	1.6.1		Konsultimi me inxhinierët e uzinës
PP2	1.6.2		Identifikimi i vendndodhjeve të mundëshme alternative
Rezultati 7		1.7	Përgatitja e propozimit formal për prezantimin dhe futjen IT.
Rezultati 8		1.8	Përgatitja e kërkesës për propozim (RPF) për ofruesit e IT.
PP1	1.8.2		Zhvillimi i kriterëve për marrjen e vendimit
PP3	1.8.3		Zgjedhje e fituesit dhe informimi i humbësve
Rezultati 9		1.9	Drejtimi i projektit pilot (ose disa projekteve pilot që përdorin variante të ndryshme të IT).
Rezultati10		1.10	Bërja e kontratës së blerjes.
Rezultati 11		1.11	Adaptimi dhe përdorimi i teknologjisë IT.
PP1	1.11.1		Nisja e sesioneve të trajnimit të punonjësve
PP2	1.11.2		Ndërtimi i sistemit të monitorimit për problemet teknike



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu

butrint.batalli@universitetiaab.com